

ALBANIAN POST

Nr. 76

DHJETËR / DECEMBER 2024

Editor in Chief: Dr. Fatmir Terziu - Telephone: 07984497444 - contact@fjalaelire.com - www.fjalaelire.com



19 Vlerësim...



20 Mjalti...




17 Liliانا...



21 Bllaca...

DY VAJZAT SHQIPTARE MAHNISIN MBRETIN CHARLES III



Dy vajza shqiptare, të cilat jetojnë me familjet e tyre në Mbretërinë e Bashkuar, duket se tërhoqën vëmendjen e mbretit Charles III, i cili ka vizituar një lagje verilindore të Londrës për të takuar përfaqësues të komunitetit, të cilët ofrojnë ndihma dhe mbështetje për refugjatët në Britani.

Juliana Shalla dhe Entela Tereziu, dy vajzat nga Librazhdi, prezantuan veshjet

tradicionale të Shqipërisë, çka duket se tërhoqën vëmendjen e Charles.

Me kuriozitet dhe i mahnitur Charles III pyet vajzat se kur kanë mbërritur në Angli dhe a janë penduar që kanë shkuar.

Camilla që shoqëronte Mbretin, dhuroi 25 lodra për t'ua dërguar fëmijëve që jetonin në hotelet e azilit, dhe një donacion në emër të mbretit që do të përdoret për ushqime.



Gezuar festat e fundvitit

HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi i shqiptarëve në Kilburn High Road. Aty ku nën drejtimin e biznesmenit Mahmut Siringul do të gjeni të gjithë produktet e cilësisë lartë dhe me çmime konkurruese.



KUALITET - CILËSI



02073721059

info@hilalfood.co.uk



322-324 Kilburn High Road, NW6 2QN



MIRË SE VINI!

WWW.FJALAEIURE.COM



PUNA FLET PËR JULIANA SHALLA

Ndërsa udhëtoja rastësisht në zonën e Walthamstow në Londër, veshi më rroku bisedat e disa shqiptarëve, të cilët po ktheheshin me sa duket nga një kurs për gjuhën angleze. Në bisedën e tyre, dhe në diskutim e sipër të nxënësve, që flisnin me një repsekt të ndjeshëm, shkëputa emrin e mësueses së tyre. Ajo ishte një mësuese e dashur, e gatshme për të ndihmuar, energjetike, e përgatitur dhe me një dedaktikë e metodologji të kapshme. Kështu flisnin ata mes vetes, sikur të intervistoheshin nga dikush. Pas kësaj dëgjova se emeri i saj ishte Juliana Shalla. Në atë rast menjëherë bëra disa kërkime dhe më rezoltoi si një figurë e njohur e komunitetit shqiptar.

Pos të gjitha kërkimeve gjeta se Juliana Shalla është një aktiviste e dashur e komunitetit shqiptar në Londër dhe ajo rezultonte se ka dhënë një kontribut të madh për komunitetin shqiptar që jeton në Mbretërinë e Bashkuar. Sipas këtyre informacioneve mësova se ajo ka qenë e përfshirë në shumë evente dhe konkurse dhe ka qenë një promovuese krenare e Kulturës Shqiptare.

Kjo më bëri që ti telefonoja dhe të kontaktoja me të. Në një bisedë të lirë kërkova të dija më shumë rreth saj dhe aktivitetit që ajo bën. Ishte vërtet një surprizë, kur mësova se ajo ka inicuar dhe ka krijuar faqen e saj të ligjshme "JEI-Education & Work services", ku ajo tashmë është duke punuar në sektorin e arsimit duke regjistruar studentët e komunitetit të saj në kurse të ndryshme dhe studime angleze dhe kjo ka rezultuar e suksesshme dhe sigurisht është shumë mjaft e domosdoshme dhe e rëndësishme.

Po kush është Juliana

Juliana jeton në Mbretërinë e Bashkuar për disa vjet dhe së fundmi është edhe e specializuar në organizimin e evenimenteve të ndryshme. Gjatë kësaj kohe ajo ka punuar mjaft në shumë organizata shqiptare dhe të komuniteteve të tjera me qëllimin e saj të mirë e të vendosur për të promovuar komunitetin shqiptar, Shqipërinë, gratë dhe të rrintë, si dhe kulturën e vendit të saj të dashur. Juliana Shalla ka punuar shumë me talentet e reja siç është 'Albanian Talent Show'. Më pas ajo inicioi dhe organizoi



Festivalin Folklorik Shqiptar në Britaninë e Madhe dhe u nderua me çmimin e rëndësishëm nga minibashkia Waltham Forest e Londrës "Lider i Komunitetit Shqiptar".

Juliana gjithashtu ka qenë themeluesja e konkursit 'Albanian Future Stars'. Në vitin 2019 ajo punoi në konkursin anglez 'Waltham Forest's Got Talent', ku ndihmoi në prezantimin e disa interpretuesve shqiptarë. Ajo ishte edhe anëtare e jurisë në këtë konkurs. Juliana pati nderin të ishte Ambasadorja Shqiptare e Ngjarjeve Kulturore në MB me kortezi të William Morris Big Local.

Në vitin 2020 Juliana ka qenë aktive si anëtare jurie në disa konkurse online duke përfaqësuar Shqipërinë si anëtare e këtyre jurive. Këto juri natyrisht përfshijnë një hapësirë të madhe, sikurse janë World Vision 2020

Armenia, Sing at Home në Itali, Good Vibes në Rumani dhe Brilliant Voices nga Monako e disa të tjera

Puna e Julianës ka qenë e vlerësuar dhe shpërblyese për të parë kulturën dhe talentin shqiptar e panjohur në Mbretërinë e Bashkuar dhe pse jo më tej në mbarë botën. Ajo ka marrë një kënaqësi të madhe dhe është nderuar të përfaqësojë Shqipërinë dhe madje edhe Britaninë e Madhe me shumë ftesa për konkurse dhe festivale dhe gjithashtu si anëtare jurie.

Në këto ditë të ndjeshme dhe të domosdoshme për komunitetin shqiptar, që përflitet mjaft nga disa media dhe nga disa zyrtarë, Juliana ka konsideruar të marrë përsipër mjetin më të mirë të modelit të saj dhe edukimit duke u mësuar gjuhën anglishte atyre që nuk kanë mundësi të tjera.





FLORA'S




Gusto Italian



Flora's Gusto Italian



!
VLERËSUAR
PËR
HIGJENË



Restoranti i munguar modern i shqiptarëve

02089047775

DY MINUTA NGA UNDERGROUNDI PRESTON ROAD



“FLORA’S GUSTO ITALIAN” NË PRESTON ROAD JU BËN FESTAT E FUNDVITIT MË TË NDJESHME

Kështu lehtësoni stresin e sezonit dhe panikun e blerjes së dhuratave në minutën e fundit duke i kushtuar kujdes erës kur bëhet fjalë për darkën e Krishtlindjes në Londër, duke i lënë profesionistët të bëjnë të gjithë punën. Një restorant i preferuar në Londër po mban hapur dyert e tij në ditën e Krishtlindjeve për ushqim, si dhe për pijet tradicionale të pasdites ose gotën e trokitjes. Mbetet i hapur ky restorant, duke u ofruar mysafirëve një pritje të ngrohtë në ditën e madhe për mysafirët dhe ata që qëndrojnë diku tjetër. Pra,

nëse dëshironi një festë të plotë tradicionale, një alternativë interesante vegjetariene, apo diçka krejtësisht të ndryshme, ne kemi zgjedhur fjalët më të ëmbla që mund të thuhet për darkën e Krishtlindjeve në Londër, duke e vizituar dhe frekuentuar pikërisht këtë restorant. Kjo është ajo, që edhe Santa do të dëshironte.

Sa hyn tek restoranti “Flora’s Gusto Italian” në Preston Road, ose më saktë vetëm dy minuta nga Undergroundi, syri sheh formën më esetike të ambientit, pastërtinë dhe mesazhin që të jep

profesionalizmi i stafit dhe tërësisë që plotëson këtë ambient sa të bukur, tërheqës aq dhe të kompletuar. Kështu festat e fundvitit, natyrshëm janë nga më të dëshiruara

duke e bërë këtë restorant nga më të kërkuarit, vlerësuarit dhe të përshtashmit për të kaluar një kohë festive të bukur e të relaksuar.

Mbi të gjitha “Flora’s Gusto Italian” në Preston Road, shkëlqen nga pastërtia dhe reklamon sigurinë më të madhe që ndodh të jetë nëpër restorante. Familjarë, individë, organizma dhe shoqata, por dhe grupe të ndryshme mund të kontaktojnë dhe të prenotojnë vendin e tyre në një drekë, darkë apo dhe në mundësi tjetër për të shijuar vërtet atë që afron vetëm “Flora’s Gusto Italian” në Preston Road.



Mendo për ëndrrën tënde,
mos u ndal!

Ne jemi këtu për Ju.
www.fjalaelire.com

Reklamo tek revista
"Albanian Post"

të shijohen në ambientin që reflekton kulturë dhe lloj-llojshmëri tradicionale dhe moderne të kuzhinës shqiptare, italiane dhe asaj më të përparuar që ekziston sot.

“Flora’s Gusto Italian” në Preston Road natyrshëm është një ide, investim dhe përkushtim i biznesmenes, ideatores dhe profesionalistes, Flora Kolaveri Osmani, që vazhdon ta udhëheq me përkushtim dhe profesionalizëm. Në prag të këtyre festave të fundvitit ajo ka shtuar gamën e ushqimeve tradicionale dhe të porositura,

Kur “Flora’s Gusto Italian” u hap me idenë dhe angazhimin e Flora Kolaveri Osmanit, ai u bë shpejt restoranti më i frekuentuar, më i zgjuar në këtë cep të kryeqytetit shpesh të ngarkuar me kalimtarë të thjeshtë e me turistë. Kur bëhet fjalë për gostitë festive, restoranti kryesor do të përfshijë një menu me pjata më pak tradicionale dhe pjata më klasike të Krishtlindjeve ku natyrisht do të gjeni dhe raki. Të gjitha të shoqëruara me një gotë Veuve Clicquot Brut, natyrisht, nga ajo që shijohet me estetikën dhe shijen e këtij restoranti të bukur dhe estetik.



Supermarketi jonë është një vend i përsosur për të gjetur ushqimin tuaj të preferuar shqiptar! Ne përdorim vetëm burimet konkurruese për të siguruar cilësinë e shportës sonë.



Oferta speciale dhe çmime konkurruese

MERRENI PRODUKTIN SHQIPTAR ORIGINAL!



151-155 BALLARDS LN, CHURCH
END, LONDON N3 1LJ



MIKU I SHQIPTARËVE



IBRAHIM AĜCAGÛL

WWW.FJALAEKURE.COM
REVISTA: "ALBANIAN POST" LONDËR

I Ibrahim Aĝcagül

Natyrishisht miqtë e shqiptarëve janë të shumtë. Sikurse ndodh me turqit ndjeshmëritë mes dy komuniteteve janë të shtrenjta, ata gjithnjë quhen vëllëzër. Kështu ndodh kur viziton supermarketin Dicle në Finchley Road. E aty gjithnjë ke miq të vetvetes, miq të shqiptarëve të sotëm e të djeshëm. Një nga ta është dhe z. Ibrahim Aĝcagül, babai i pronarit të Dicle në Finchley Road, zotit Ali, dhe një biznesmen me emër në kohë të ndryshme, që natyrishisht na jep shumë gjëra të mirëfillta dhe në kohë reale. Një bisedë me z. Ibrahim Aĝcagül udhëton në dimensione të shumta. Dhe natyrishisht pikëtakimi është respekti dhe trëgësia e sinqertë. Ai gjithnjë i do shqiptarët dhe i ka ndihmuar mjaft familje shqiptare në mënyrë humane të disa raste, sikurse ka qenë një rast i vërtetuar nga ne. Kështu

ai jo vetëm me këtë por dhe me edukatën që i ka dhënë të birit, atë familjare dhe tregtare të përkushtimit ndaj vlerës dhe respektit është bërë gati një qendër për shqiptarët e asaj ane londineze. Dhe shqiptarët më shumë se kurë frekuentojnë, bëjnë blerje dhe pëlqejnë si gjithnjë ushqimet e përbashkëta në këtë supermarket, ku

nuk mungojnë dhe ato nga Shqipëria, që tashmë janë të shumtë. Duke ditur se marrëdhëniet tregtare midis Turqisë dhe Britanisë së Madhe kohët e fundit kanë marrë një dimension të ri, edhe vlerat e tregëtisë kanë marrë konsideratë të jashtëzakonshme mes komuniteteve. Veçanërisht në teknologji dhe inovacion, partneritetet po zhvillohen ndërkohë që sipërmarrësit turq gjejnë mundësi të rëndësishme në MB. Sipas Kenan Poleo, Konsullit të Përgjithshëm Britanik në Stamboll, këto mundësi shërbejnë si një urë për sipërmarrësit turq për të rritur bizneset e tyre dhe për të hyrë në tregjet globale. Ja një pamje gjithëpërfshirëse nga Konsullata e Përgjithshme mbi atë që i pret sipërmarrësit turq në MB.

Me këtë rast edhe biseda e lirë me z. Ibrahim Aĝcagül dhe me vetë z. Ali Aĝcagül na përforcon atë që lexojmë tek mesazhi i Kenan Poleos, që përkthehet në këtë mënyrë: "Sipërmarrësit kanë potencial të madh në MB. Ju mund të përdorni mundësi të bollshme financimi dhe një ekosistem mbështetës duke

marrë pjesë në ngjarje si Java e Teknologjisë në Londër.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë

Për të forcuar më tej marrëdhëniet tregtare të vazhdueshme midis Turqisë dhe Mbretërisë së Bashkuar, një Marrëveshje e re e Tregtisë së Lirë (MTL) po negociohet midis dy vendeve. Duke dhënë informacione për këtë marrëveshje, Poleo thotë, "Prioriteti ynë është të nënshkruajmë një marrëveshje që do të sigurojë qarkullim më të lirë të tregtisë dhe shërbimeve. Ne do të fokusohemi në sektorin e shërbimeve dhe teknologjisë."

Diversiteti Kulturor dhe Sipërmarrja

Një nga avantazhet e të bërit biznes në MB është diversiteti kulturor. Poleo thotë: "Mbretëria e Bashkuar është me të vërtetë një vend global. Është një vend ku mund të gesh kultura të ndryshme dhe të ndihesh i sigurt dhe i mirëpritur." Këtu, sipërmarrësit jo vetëm që rrisin bizneset e tyre, por gjithashtu

marrin pjesë në ngjarje të pasura kulturore dhe zgjerojnë rrjetin e tyre duke takuar themelues të tjerë. Kështu bisedat tek miqtë e shqiptarëve në supermarketin Dicle kanë gjithnjë një domethënie të madhe, që mbetet tek realiteti, reciprociteti dhe respekti reciprok.





JETË TË GJATË PROF DR ESHREF YMERI!

Prof Dr Eshref Ymeri është ende në tryezën e tij të punës, pasi ai po përcjell mes faqeve shënimet e krasitjet e fundit në veprën e tij të radhës që mbetet si një pasqyrë globale, jo vetëm për Tjetrin, por dhe për vetë ekzistencën e një shteti që ka kusuret e mëdha jetike para kësaj pasqyre. Ai ka vite që mbledh e shkruan një vepër për Rusinë egoiste, që ndoshta ky është thelbi i saj, thelbi i kësaj vepre, që vetë Rusia të jetë në gjëndje të kuptoj vetveten e saj anarkiste. Janë qindra e qindra intervista e mbledhje faktesh që flasin dhe e bëjnë këtë vepër madhore jo vetëm mjaft të pritshme, por dhe të ndihshme, pikërisht njësoj si atë mitin e pasqyrës që ka ekzistuar që në lindjen e saj. E kështu mendja dhe dora e Prof Dr Eshref Ymerit e ka harruar ardhjen në jetë, ka harruar ditëlindjen, ndërsa në tryezën e tij të ngushtë familjare trokiten gotat e urimit për ditëlindjen, Havaja e tij e shtrenjtë dhe e dashur, i kujton se tashmë është koha për të trokitur Gëzuar, si atëherë, si atë ditë... kur gëzimi vinte me një zjarr nga sytë.

Tjetra është ajo që vjen nga të gjitha anët, se Prof Dr Eshref Ymeri, ka miq e kolegë, ka shokë e akademikë, ka vlera e të vlerësuar, ka mjaft e mjaft që rendin të dërgojnë urimin e parë, urimin plotë mall. E kush nuk do të dëshironte të uronte një vlerë kaq të madhe Kombëtare? Ai është ideator, krijues, botues dhe realizues i disa fjalorëve me thelb Gjuhën Shqipe dhe kontekstin në disa gjuhë të huaja, ai është autor i qindra e qindra artikujve me karakter Kombëtar, ai është zëri i qindra kritikave me dorë të mbarë, ai është ashtu sikurse e kam cituar Filozofi modern mes dy kohëve. Dhe ky Njeri modest, që është Akademik, dhe jo me cipalin ilustrues të atyre që vijnë nga ndonjë shoqatë në Amerikë, por me thelbin e tillë të merituar nga puna e tillë. Dhe ky intelektual që është autor i disa librave natyrisht mbetet

dhe intelektual i më i thukët i sfidave. Sot, ndoshta me një tjetër arsye ai vjen më i fortë në këtë ditëlindje, pasi ai e kupton se pas ardhjes së ditëlindjeve pas çdo kohe, ka dhe një arsye moshe. Dhe këtë e themi pa frikë, për Prof Dr Eshref Ymerin ditëlindjet janë thjesht aritmetikë.

Prof Dr Eshref Ymeri, ose Filozofi modern mes dy kohëve

Teksa pija një gotë raki Shqipërie në kryeqytetin shqiptar, Tiranë, pas disa vitesh larg saj, me të ndjerin, një nga penat që bëri mjaft për letrat shqipe, shkrimtarin Siri Sulejmani, natyrisht dhe një nga shëndetet tona, do të shkante për Prof. Dr Eshref Ymerin, (të cilin fizikisht ende nuk e kam takuar asnjëherë). Në bisedë e sipër ai më tha fjalë për fjalë kështu: "Eshrefi është një "antioksidant" ideologjik i ditëve tona që jetojmë". E thellova pyetjen time dhe kureshtja ime dëgjoi me vëmendje se "Eshrefi, pra për njeriun të cilin e dëgjoja në atë bisedë nga një shkrimtar si Siriu, mjaft rebel në mendime, ishte dhe mbetej një intelektual mjaft i rëndësishëm, fisnik, i kompletuar dhe mjaft didakt. Pra, i saktë, i qashtë, i rreptë në mendimet e tij."

E kështu fillova të lexoj ngadalë dhe me vëmendje, hap pas hapi njeriun që kishte lindur në fshatin Mesaplik të Vlorës më 25 dhjetor 1938. Ndërkaq në jetërrugëtimin e tij do të gjeja edhe shkollimin e tij që fillonte me arsimin fillor në Mesaplik, shtatë vjeçaren në fshatin Ramicë dhe me Gjimnazin "Ali Demi" të Vlorës që e kishte mbaruar në vitin 1959 me rezultatin "shkëlqyeshëm". Nga ky rezultat i përpjekjeve të para për t'u pajisur me dije dhe kulturë, i ishte dhënë e drejta për të studiuar në Leningrad të ish-Bashkimit Sovjetik për gjuhën ruse. Kur u prishën marrëdhëniet me B.S, në qershor të vitit 1961 ai ishte kthyer në Shqipëri dhe



kishte vazhduar Universitetin e Tiranës për gjuhë letërsi ruse në fakultetin "Histori Filiologji", të cilin e kishte mbaruar me rezultate të larta në vitin 1966. Emërimi pedagog në katedrën e gjuhës dhe letërsisë ruse dhe më pas shef të redaksisë së botimeve në gjuhë të huaja deri në vitin 1990, e kishin formësuar më tej figurën komplekse të Profesor Ymerit. Gjatë kësaj periudhe ai kishte drejtuar redaksinë për përkthime në gjuhë të huaja. Më pas viti 1992 sërish me punën si pedagog për gjuhën dhe letërsinë ruse, deri më 31 gusht 2003, e mbajti në vëmendjen e madhe dhe pasionin e tij intelektual deri kur doli në pension. Dhe vërtet ka dalë në pension Prof Dr Eshref Ymeri? Këtu qëndron enigma e një intelektualit të tillë "antioksidant" ideologjik, që në leximin e filozofit të kohëve moderne, Slavoj Žižek është i lidhur jo thjesht me reklamën, por me punën që jep dhe merr Tjetri nga një "benefit" i tillë i mjaftëdobishëm mendimi, filozofie dhe intelektualizmi nga më të radhët në shoqërinë e sotme shqiptare.

Ndërsa Slavoj Žižek e lidh këtë me paketën e çajit "Çaj qiellor", ku ka një shpjegim të shkurtër të përfitimeve të tij: 'Çaji jeshil është një burim natyror i antioksidantëve, të cilat neutralizojnë molekulat e dëmshme në trup të njohura si radikalet e lira. Duke zbutur radikalet e lira, antioksiduesit ndihmojnë trupin të mbajë shëndetin e

tij natyror.' Ky lloj "çaji qiellor" në kuptimin filozofik, është nocioni i pastër që lufton me rrënjë aspektualitetin e totalitarizmit dhe është një nga antioksidantët kryesorë ideologjikë, funksioni i të cilit gjatë gjithë funksionit jetik është të zbusë radikalët e lirë dhe kështu të ndihmojë trupin social që të ruajë shëndetin e tij politiko-ideologjik. A nuk e bën një të tillë Prof Dr. Eshref Ymeri me të gjitha shkrimet dhe veprat e tij? A nuk e ka treguar dhe me analizat e thelluara, apo dhe me komentet e thjeshta? Shkrimet e tij, thellimet në mendime, sigurisht që janë jo thjesht një lexim stimulues, por dhe një morfologji dhe sintaksë më vete për mjaft udhërrëfime në fusha të ndryshme, përfshirë historiologjike, gjuhësore, inter-kërkuese, nacionaliste dhe më tej artdashëse. Në stilin tipik të tij Profesor Dr Eshref Ymeri, prezanton tërësinë e tematikave që trajton si një meditim mbi përdorimin e nocionit logjik të shprehjes. Ajo që Ymeri shërben, është një diskutim i çuditshëm rreth temës së sotme të shqiptarit të kudogjendur, rreth angazhimeve dhe mendime intelektuale dhe politike, rreth tërësisë së vlerave dhe mangësisë qeveritare, duke u mbështetur në interesin e gjerë akademik, duke filluar nga psikoanalizmi deri te materializmi dialektik dhe studimet moderne kulturore. Por për të gjitha këto, ai të bën të mendosh...



KOMPANIA “DOKO” - 30 VITE SUKSES DHE LIDERSHIP NË ENERGJI!

Këtë vit kompania “Doko” festoi me krenari 30 vite përkushtim dhe arritje në ndërtimin e linjave të tensionit të lartë dhe nënstationeve, thuejt në një postim publik të kësaj kompanie që shoqërohet dhe me një fotografi mjaft domethënëse. Dhe ndërsa e lexon dhe shijon përmasat e suksesit për mikun që e njeh me kohë, natyrisht dhe në leximin e veçantë të veventit dhe vetë imazhit të fiksuar udhëtimi i shkrimit shkon më tej. Dhe e dini pse?

Kur përmend emrin e Bardh Dokos në Elbasan e më gjerë, natyrisht mjafton vetëm kaq të shkosh tek Njeriu që gëzon respektin për suksesin dhe respektin e suksesit dyfish. Ndërsa kur shkon më tej dhe përmend Kompaninë “Doko” që ka operuar tashmë rreth tridhjetë vite në ndërtimin e linjave të tensionit të

lartë dhe nënstationeve, ajo që bashkon respektin për suksesin dhe respektin e suksesit formon një diskurs më vete. Ky diskurs ndoshta është vetë thelbi tek fjalia, që lexohet pas këtyre tridhjetë viteve nga vetë lidershipi i kësaj kompanie: “Gjatë këtyre tri dekadave, kemi ndërtuar jo vetëm infrastruktura energjetike, por edhe ura bashkëpunimi, besimi dhe cilësie me partnerët tanë.” Me këtë koncept dhe këtë diskurs ntyrshëm gjithkush

e kupton thelbin, se nëse suksesti është një koncept gjithmonë i pranishëm, ai përforcohet veçanërisht nëse jeni serioz për udhëheqjen e këtij suksesit. Ne të gjithë duam të ndihemi të suksesshëm dhe të shihemi si të suksesshëm nga bashkëkombasit tanë, dhe sigurisht që nuk mungojnë këshillat se si të arrijmë atje, kur natyrshëm ke një Kompani të tillë model referimi, kur ke një ekip dhe një lidershhip kaq kompakt, që ka nderuar

veten, vendin dhe Kombin në jo pak raste, pasi kjo Kompani operon dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Dhe kur sheh një sukses të tillë dhe një respekt të suksesit të vlerësuar, natyrshëm mendja të shkon tek lidershipi, dhe pa e mbajtur në kuadratin e modestisë, sikurse është ai, Bardhi, natyrshëm me kohë ka ndjekur parimet themelore të të bërit i suksesshëm, duke mësuar epër mirësuar, duke komunikuar në mënyrë efektive dhe duke qrnë në gjendje të

menaxho kohën në të mirë të procesit. Tre parime të tilla, tashmë janë trashëguar tek djemtë e tij, që kanë stafetën në dorë, pas disa kualifikimeve të suksesshme në Britani të Madhe e në hapësira të tilla, pa përjashtuar vetë eksperiencën në Kompaninë “Doko”. Dhe nëse shkojmë më në detaj, mjafton të shikojmë fotografinë. Epublikuar me rastin e festimit kolektiv të tridhjetë vjetorit të Kompanisë “Doko”, ku natyrshëm përveç

asaj që dihet se një fotografi ka gjuhën e vet, dhe flet me mijrëa fjalë, ka dhe një çelës magjik, që bashkon edhe formatin logjik, transparent dhe estetik. Këtu është thelbi që bashkon dhe nuk ndan, pasi të lë që të nënkuptosh se të gjithë në atë gjysëm hark, majtas dhe djathtas shkallëve të qasjes dhe midisja në thelb flasin e sigurojnë arritjen kryesore me punë e përkushtim për suksesin në të njëjtën mënyrë. Kjo fotografi ka dhe një mesazh për të gjithë, dhe për vetë

Kombin, ku duhet që gjithkush të besoj e të shpresoj se me punë e përkushtim të njëjtat gjëra do të na bëjnë të gjithëve të ndihemi të suksesshëm. Pra, me diskursin e saj kjo fotografi flet qartë se me të njëjtat hapa krijojmë sukses për të gjithë. Nënteksti në ndjekjen e nocionit popullor se suksesit do të thotë e njëjta gjë për të gjithë është një shtysë më shumë që duke ndjekur ëndrrën e dikujt tjetër, ju realizoni dhe ëndrrën

tuaj. E shohim gjatë gjithë kohës. Profesionisti që ka shpenzuar vite duke ndërtuar një karrierë, vetëm për të kuptuar se çfarë dëshironte të bënte ishte diçka ndryshe gjatë gjithë kohës, kur një kohë e bëri ëndrrën të jetë jo vetëm realiztet por dhe sukses e inspirim në jetë. Pronari i biznesit që sakrifikon atë që ka vërtet rëndësi për të ndjekur rritjen me çdo kusht, natyrisht një i tillë.

Të hartosh nocionin tënd të suksesit, dhe të mirëkuptosh dhe vetë nocionin e respektit tek Kompania “Doko” e lexon dhe në vetë kontekstin e urimit “Faleminderit të gjithë klientëve, partnerëve dhe ekipit tonë të palodhur që kanë bërë të mundur këtë rrugëtim.” Ky urim i bën të gjithë të ndihen energjik dhe të kënaqur. Por, udhëtimi është larg nga përfundimi, pasi Kompania “Doko” shton “Për 30 vite të tjera sukses dhe energji për të ardhmen!”





NJË BISEDË PËR FAMILJEN KULLAFI NDËRSA MAKINA RRËSHKET ASFALTIN NË FUSHË STUDËN

Dhe ngjitja nga Librazhdi tashmë ndryshe në rrugën e Fushë Studnës. Pasi ke pirë ujin e freskët të Çesmës së Llangës, ndjen kohërat dhe fatet në hapësirën e tyre jetike. Dikur këtë rrugë e kam bërë thujse çdo të hënë e të shtunë, kur punoja mësues në Ostren të Madh. Dhe ndërsa tashmë ndjej rrëshkitjen e gomave në asfaltin e rrugës së re, natyrisht shkoj në kohën pas dhe shoh si në një ekran të madh barghë e zi fatet e lëvizjeve njerëzore. Fatet dhe kohërat e fateve?!

Ata nuk vijnë hapur në jetën tuaj. As nuk imponojnë praninë e tyre në jetën e përditshme. Njerëzit e fatit trokasin vetëm shpirtrat përpara një brave të ndryshkur nga braktisjet për të lejuar një rreze drite të depërtojë në tjetërsimin vdekjeprurës të kohës për një kohë tjetër dhe të tregojë rrugën në dritëhijen e një kohe të harruar, por në dimensionet e një kohe tjetër që duhet të vazhdoni. Deri në episodin tjetër diellor të qenies. Aty ku çdo gjë bie në vend dhe ju tashmë e dini se çfarë të bëni me të mirat që ju kanë lënë trashëgim. Sepse njerëzit e fatit nuk janë thjesht shokët tuaj, as ata që ju ngulni dhe shkulni memorijen për ti kujtuar. Ata janë vetëm një ndriçim i lumtur për të bekuarit që janë në gjendje ta shndërrojnë dëshpërimin në urtësi, ta bëjnë urtësi udhën e tyre, e të familjes së tyre.

Ishin vitet kur nisi të dukej frymë e një kohe tjetër edhe në këtë rrugë, edhe në Fushë Studnë dhe vendi po shpërthente nga turma njëvëzhish të varfër që kishin dalë në rrugë në tornadon e një proteste të brendshme për liri, jetë më të mirë dhe për të menduar më tej për familjen dhe fëmijët. E gjitha kishte shumë perceptime, por pak njohuri me atë që po vinte, me atë që do të ndodhte. Dukej sikur rryma që mungonte nga banesat e tyre të ftohta elektrizoi hapësirën

me qarkun e shkurtër të zemërimit dhe tmerrit i dimrit të pafund infektui ajrin me mikrobet e dëshpërimit. Gishtat e shtrënguar në një shtrëngim të dëshpëruar, Fushë Studna, dhe tërë fshatrat përreth, u përpoqën të kalonin rrymën e zemërimit njerëzor për të arritur në albumin e dashur, ku, të strukur nga lodhja socialiste, i priste tërmi i ri i përditshëm, me motorin ende të ndezur për një drejtim të pakuptueshëm mirë ende. Si një këngë motorike e një poezie të vjetër të hedhur në vërshimin e tërbimit popullor, nisi dhe vendimi i shumë familjeve të kapeshin pas lëvizjes së lirë, në një kondicion të ri, kurbetqar edhe në fatet e kërkimit etyre brenda dhe jashtë vendit. Në mes të rrugës që dëborë kishte mbuluar dheun e butë e të zi që prodhon patatet më të mira në vend kishte dalë vetë fusha dhe kështu gjithkund lindi mëdyshja.

Të paktën kështu m'u duk mua në atë kohë, ky individ i dashur me sytë tek e padukshmjka duke shtrënguar nën krah një dosje të fryrë me dhurata të pavërejtura nxënësish në vite mori udhë tjetër por kurë jashtë shkollës. Surrealizmi nuk është gjithmonë një largim tronditës nga realiteti. Ndonjëherë, ai është në gjendje të japë shpresë. Burri ndoqi me qëllim zigzagun e hapave tanë të nxituar dhe dukej se na tërhiqte drejt tij me fillin e padukshëm të shikimit të tij të qeshur. Isha i sigurt se do të fliste me ne. Megjithatë, nuk e prisja që gjuha e tërheqjes sonë nga memorija gjithëpërfshirëse do të ishte rrëfimi këtë herë. Dhe ai është ish-nxënës i mësueses Zylfije Kullafi, për të cilën na flet me shumë respekt dhe nxjerr fjalët më të mira për të. Ai na shërben tashmë kafënë ekspres në një nga vilat e kësaj zone. Dhe ne e dëgjojmë...

Zylfije Kullafi ka lindur në Fushë Studnë të Librazhdit, pjesë e Parkut Kombëtar të Shebenikut


Shkollën 8 vjeçare e mbaroj në fshatin e lindjes. Më 1985 mbaroi arsimin pedagogjik në shkollën e mesme pedagogjike "17 nëntori" Tiranë. Arsimin e lartë për mësuesi e mbaroi në Tiranë, dhe u kualifikua si mësuese e ciklit fillor. Më 1985 fillon punë në shkollën e Fushë Studnës. Në Mars të vitit 1987 martohet me Çaus Kullafin, djalin nga Letmi i Librazhdit i cili punonte mësues në shkollën e mesme të përgjithshme "Hajdar Kullafi" në Letëm. Po këtë vit ajo emërohet mësuese në këtë shkollë. Në tetor të vitit 1995 transferohet mësuese në shkollën "Vëllazërimi" Tiranë ku punon dhe sot. Zylfija ka patur rezultate të larta në klasat që ka dhënë mësim. Shumë nxënës të saj kanë marrë çmime të para në shkallë kombëtare arsimore. Ka një bashkëpunim frytdhënës me drejtoreshën e shkollës Merita Prenga, kjo e fundit mësuese letërsie dhe e apasionuar në krijimtari. Zylfija këtë vit jep mësim në klasën e pestë ku ka mjaft talente, ku shquhet në shkrimin e eseve nxënësja Ajsel Ballgjini. Në kohën e pandemisë bashkë me Çausin dhe vajzën e saj Majlindën, mësuese anglishte, në shkollën Tahir Sinani dhe pedagoge e jashtme në Fakultetin e mjekësisë Tiranë e kthyen shtëpinë në klasa shkolle në mësimin virtualisht me nxënësit. Ajo nga viti 1987 e deri tani punon në të njëjtën shkollë me Çausin.

Pasionante në punë dhe një motivuese e mirë e nxënësve të talentuar. Bashkëshorte model, gjyshe e kujdesshme. Ruan dashuri për vendlindjen e saj. Gëzon respekt në komunitet. Mësuese që prindërit kërkojnë që t'i kenë fëmijët në klasë me të. Ndihej kryesore në krijimtarinë e Çausit. Është njëra nga mësueset e para bashkë me Elinda Kuzarin dhe



Qefsere Shumën në hapjen e shkollës "Vëllazërimi", foto e saj bashkë me shënimin mësuesja e parë e kësaj shkolle qëndron në stendën e historikut të shkollës

Më pas nga biseda me këtë ish-nxënë të saj mësova se Çausi dhe bashkëshortja, Zylfija, janë mësues në ciklin e ulët të shkollës 9-vjeçare "Vëllazërimi", kurse e bija e tyre Majlinda, është mësuese e gjuhës angleze në shkollën 9-vjeçare "Tahir Sinani" Tiranë dhe jep mësim në klasat e teta dhe të nënta. Mësova gjithashtu se vajza e madhe e Çausit është juriste në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, kurse vajza e tretë vazhdon studimet në Munich të Gjermanisë master, dega Menaxhim dhe Teknologji me fokus Marketing strategji dhe informacion informatikë. Djali, Nadmiri, gjimnazist me prirje dhe talent edhe për aktor, sapo mbaroi maturën në gjimnazin "Partizani" të kryeqytetit dhe pret të fillojë studimet e larta...



46 BIRCHINGTON ROAD
NW6 4LJ

Restoranti I SHQIPTAREVE

Restaurant Bar "Imperial"

"Shijoni shijet e pjatave tona të shkëlqyera, ku çdo
kafshatë tregon një histori të shijshme."



Kualitet

Dasma

Ne ju ndihmojmë në
perfeksion



Cilësi

Festime

Ju a bëjmë më festive
festën tuaj



Pastërti

Familjare

Ne jemi si një familje
ndaj e dimë
familjaren

Rezervo



020 7624 1385



EDUART BALA: PROFESIONALIZMI PËR DËRGESAT TUAJA

Ju njoftojmë se kompania që drejtohet nga Mondì, që është dhe mbetet kompania më e sigurtë dhe më profesionale e transportit të mallrave nga Anglia drejt Shqipërisë dhe anasjelltas, do të kryejë destinacionin e saj përkatës të radhës duke grumbulluar mallrat në datën 26 tetor 2023 në këto qytete britanike: Birmingham, Luton, Banbury, Oxford, Coventry, Northampton, Manchester, Leeds, Sheffield. Po ashtu ju njoftojmë se nisja e destinacionit përkatës nga Shqipëria drejt Anglisë bëhet në datën 5 Nëntor 2023. Për më shumë informacion kontaktoni drejtuesit e kësaj kompanie në celularin që jepet në fund të këtij shkrimi.

Mjaft kompani transporti e nisin me një slogan sikur janë qindra vjeçarë në këtë profesion të ri të tyre. Dhe më së shumti duan të theksojnë se kanë kryer dhe transporte të mëdha, kur dihet se si njëra dhe tjetra janë vetëm tentativa dhe lojëra fjalësh.

Kompania që drejtohet nga Eduard Bala (Mondì) mbetet më e saktë dhe me një eksperiencë të gjatë, natyrisht jo vetëm në Shqipëri dhe Angli dhe në destinacione të tjera ndërkombëtare në fushën e transportit ndërkombëtar të mallrave dhe mjeteve të ndryshme, ofron për të gjithë klientët e saj një shërbim të kompletuar dhe sigurt transporti i destinuar mbetet prioriteti dhe profesionalizmi, besimi dhe konsiderata efikase.

Siguria, shpejtësia dhe garancia e punës së zhvilluar ndër vite ka bërë që sot shumë bashkëathetarë dhe miq, të tjerë të lidhur me Atdeun tonë të dashur dhe mjaft anglezë madje që kanë shkuar të

eksperiencia e saj dhe nga aktiviteti serioz, po aq dhe nga respekti, nga përkushtimi dhe përgjegjësia e plotë gjatë gjithë procesit të grumbullimit të mallit deri në dorëzimin e tij në destinacionin final, mbetet

standarteve të një shërbimi transporti modern dhe efikas, me një garanci, mosprishje të mallrave, dhe me dërgimin pa probleme të tyre. Vizioni natyrisht mbetet qartë, të vazhdoj të mbetet një kompani lider i padiskutueshëm në transportin e Mallrave nga Britania e Madhe dhe vende të tjera të Europës drejt Shqipërisë dhe anasjelltas.

Kjo kompani funksionon me furgonë të posaçëm për këtë punë dhe me dy drejtues makinash të sprovuar në mjaft vende të huaja.

Nëse jeni duke kërkuar për një kompani cilësore, efektive, transparente, kompetente, të besueshme dhe profesionistësh, atëherë kjo është zgjedhja e duhur dhe e domosdoshme në çdo kohë.

Me këtë transport, e gjitha që ju dërgoni dhe prisni të merrni në destinacionin tuaj është në dorë të sigurtë dhe me garanci të plotë.

Duhet theksuar se mbi 50kg i marrin dhe i dërgojnë në destinacion.

Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

TRANSPORT
ANGLI-SHQIPËRI
MALLRA DHE MATERIALE

SHPEJT
SAKTË - RESPEKT

BEST PRICE!

TRANSPORT MALLRASH: ANGLI-SHQIPËRI & SHQIPËRI-ANGLI

Mbi 50kg i marrim dhe i dërgojmë në destinacion.

- ANGLI:
• +447395287400
- SHQIPËRI:
• +355 68 3676859

VLERA PROFESIONALE

SAKTËSI - KURSIM

RESPEKTI NDAJ KLIENTIT
NA PROVONI



Respekt-Shpejtësi-Saktësi-Garanci-Kualitet

investorë në Shqipëri, po aq dhe imigrantët që jetojnë, punojnë dhe studiojnë, prej shumë vitesh në Britani të Madhe dhe në Europë kanë ardhur në pikën më të mirë të mirëkuptimit të besojnë transportin e mallrave të tyre drejt Shqipërisë.

Duam të themi se kjo kompani e njohur tashmë nga

konkurrese dhe në çmime.

Ajo mund të kontaktohet në numrat e telefonit ose në WhatsApp, Viber, Facebook, Instagram dhe e-Mail për tu informuar mbi datat dhe lokacionet e grumbullimit dhe shpërndarjes së mallit. Misioni i kësaj kompanie është të vazhdoj rrugën e suksesit në vijimin dhe përmbushjen e

TRANSPORT MALLRASH:
ANGLI-SHQIPËRI &
SHQIPËRI-ANGLI

ANGLI: +447395287400

SHQIPËRI: +355 68 3676859



NJË GRUP PROFESIONAL NXJERR NGA THELLËSIA E LETËRSISË PËR FËMIJË THELBIN E DISKURISIT NË NJË ANTOLOGJI TË MUNGUAR

Dhjetë vjet më parë pa dritën e botimeve një Antologji e munguar dhe e shumëpritur. Larmia e letërsisë për fëmijë u bë më e prekur se kurrë ndonjëherë në botimin e një Grupi Profesionistësh të kësaj krijimtarie. Themi kështu se duke u ndalur tek pikat dominuese të librit për fëmijë dhe përgjithësisht prirjet e botimit të letërsisë për fëmijë në vendin tonë, Grupi redaktorial dhe përzgjedhës arriti të sjell për të gjithë një vepër të kompletuar. Autorët e lartcituat kanë një përvojë të madhe, por studiuesit fokusohen në vepra specifike nga e kaluara e afërt, dhe ai në rolin e vetë protagonistit të kësaj letërsie shqyrton letërsinë për fëmijë në periudhën 2000-2014-të, dhe prurjet për këtë çështje janë një përzgjedhje e rrallë. Libri “Lule për Lulet- Antologji e Letërsisë për Fëmijë” (Tiranë, 2014) nga Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës, i vetëpërcaktuar si një përmbledhje autorësh dhe krijimesh të seleksionuar të tyre, përpiket të shikojë botën e shkrimit për fëmijë, duke i vendosur vetes synimin shumë ambicioz për të parë periudhën e viteve në konsideratë, dhe të arrij një përmbledhje të tendencave në letërsinë për fëmijë këto ditë. Ai përmban rreth tetëdhjetë e tre autorë dhe krijime individuale, të renditur në mënyrë kronologjike dhe që komentojnë autorë individualë dhe veprat e tyre, që përfshijnë të tre gjinitë letrare. Janë paraqitur autorë që shkruajnë si për të rritur ashtu edhe për fëmijë, por theksi është tërësisht në atë që ata kanë krijuar për lexuesit më të vegjël. Libri është i organizuar rreth dy bërthamave, nga njëra anë, synon të komentojë autorët si prezantues, dhe nga ana tjetër, përpiket të përvijojë diskursin krijues me përzgjedhjet dhe qëndrimin ndaj letërsisë dhe leximit në

fjalë, interesat e fëmijëve në kontekstin modernë, analizon zgjedhjen e drejtimit, pa u thelluar në tekst analitik, por me ndihmën prurëse që këtë ta bëjë lexuesi. Ndërsa ndodh që shtëpitë botuese në lidhje me librat për fëmijë botojnë letërsi, tema dhe tabu gjuhësore në shkrimin bashkëkohor, nuk ndodh që të bëjnë një vepër të tillë, një vepër të munguar etë domosdoshme të cilën autori dhe grupi ndihmës e kanë bërë realitet me një mundim të madh dhe me shumë pak fjalë në kontekst, pasi ta themi të vërtetën janë shumë modestë.

Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës me shumë kujdes zgjedh saktësisht se çfarë duhet të theksojë në seleksionimet e librit, të cilët nuk kanë lidhje tematike, por të bashkuara rreth idesë për të paraqitur ndryshimet në kontekstin e përzgjedhjes. Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës ndalet në atë që dihet pak, por meriton t’u prezantohet lexuesve akoma më shumë. I tillë është rasti me me disa autorë të njohur kryesisht si krijues për të rritur, ndërsa poezitë e tregimet, krijimet e tyre për fëmijë janë të marginalizuara. Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës me diskursin e tij përzgjedhës në këtë kontekst arrin të imponojë gjuhën poetike, në të cilën autori e konsideron fëmijën të shndërrohet fare natyrshëm në “shok skuadre”. Veprat e tilla të përfshira në këtë Antologji janë të paharrueshme dhe figurative, gjë që krijon idenë e “të parit” dhe “të dëgjuarit” në diskursin më efikas të një veprë kaq të dosmodoshme për studentët, hulumtuesit, kërkuesit shkencorë e më së shumti për vetë diskursin e njohjes së kësaj krijimtarie shqiptare në këtë periudhë domethënëse. Krahas kësaj, autori ristrukturon në tërësi atë që shkrimtari, poeti, autori

i një prurjeje a më gjerë shtron **p r o b l e m e t** parësore si kërkimi i rrugës së drejtë, vetmia dhe simpatia, të cilat prekin lexuesin e ri dhe janë ndër temat kryesore të letërsisë për fëmijë në këtë periudhë.

Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës fokusohet edhe tek tekstet e shkurtra letrare. Shembull në këtë drejtim janë disa poetë, të njohur si të tillë, por që në fakt proza e tyre për fëmijë mbetet në hije. Me këtë shkas lexuesi arrin të gjej një krahasim midis koleksioneve individuale, që u përmbledhën me bërthamat kryesore tematike, ku kërkohet vendi dhe roli i fëmijës në to dhe marrëdhënia e fëmijëve me botën. Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës është munduar të konsideroj më të mirë, duke anashkuar atë që mund të konsiderohet mangësi nga ritregimi i disa historive, por vetë analiza e sugjeron, pasi ai ristrukturon mjeshtërisht pohimet individuale që të mos duken sipërfaqësore si prurje në Antologjinë në fjalë.

Në përgjithësi, forca e librit Lule për Lulet- Antologji e Letërsisë për Fëmijë shprehet në komentin e gjendjes së letërsisë moderne për fëmijë. Padyshim që sot është shumë ndryshe, pasi lexuesit e saj kanë interesa dhe nevoja të tjera. Fëmija thith të tashmen dhe autorët shkruajnë për atë që do ta provokonte. Në këtë rast, pyetja nëse fëmijët mund të dallojnë botën e përrallave, ku gjithçka është e bukur dhe e mirë, nga ajo reale është shumë e rëndësishme.



Kjo është prekur nga autori dhe kujton diskutimin nëse duhet të ndalohen përrallat e fëmijëve që shtrembërojnë pikëpamjen e fëmijëve për botën përreth tyre? Në sferën e vëmendjes së autorit janë edhe botimet për fëmijë dhe sa të përshtatshme janë për ta. Në këtë periudhë të marë në konsideratë aturoi gjen dhe hulumton me rëndësi librat të botuar për fëmijë, kushtuar tematikave të ndryshme për fëmijë. Antologjia e realizuar nga Grupi Redaktorial dhe Përzgjedhës na sugjeron se ekziston gjithashtu një rritje e interesit për letërsinë fantazi, me ndryshimet në lëndën e letërsisë për fëmijë që kërkojnë natyrshëm ndryshime në gjuhën në të cilën janë shkruar librat për fëmijë. Kjo Antologji na jep mundësinë që të analizojmë problemin sesi fëmijët rriten me dashurinë për tabutë dhe se si cinizmi shprehet përmes fjalëve të fëmijëve, që përbën një sfidë jo vetëm për autorin, por edhe për përkthyesin kur ai do të duhet ta transferoj për një gjuhë të huaj...



IKU NË AMSHIM POETI SEJDI BAJRAM BERISHA

Një lajm i hidhur më erdhi nga Peja, që lajmëronte se Sejdi Bajram Berisha kishte ndërruar jetë. Në mesin e krijesve shqiptarë nga Peja e më gjerë e njihnin si Sejdiu. Ishte i njohur, i pranishëm dhe fjala i peshonte shumë. I peshonte si ato ditë kur e takova në qytetin e tij të dashur, për të cilin gjithnjë shkruante se ishte "poezia që kurë s'e kishte mbaruar". Dhe sikurse shkruanin miqtë e tij ai bënte pjesë në plejadën e krijesve të shumënumërt të opusit të gjerë letrar në gjuhën shqipe nga Peja, Kosova dhe më gjerë padyshim. Kështu shkrimtari, publicisti dhe kronisti, Sejdi Bajram Berisha tashmë nuk është në përditësinë e tij prezente. Ai është thirrur nga Zoti që të plotësoj misionin tjetër në krahët e tij, atë mision të nisur në Tokë...

U lind më 10 qershor të vitit 1947. Qysh si nxënës i shkollës fillore, fillon të shkruaj poezi, të cilat së pari i botohen në gazetën "Flaka e Vëllazërimit" të Shkupit, pastaj në gazetën (revistën) për fëmijë "Pionieri" dhe në "Rilindja për fëmijë". Nga këtu zë fill edhe zhvillimi i talentit të tij edhe si shkrimtar edhe si gazetar.

Si nxënës i Gjimnazit "11 Maji" të Pejës bashkëpunon me gazetën studentore "Bota e Re", kurse që nga viti 1970 bëhet bashkëpunëtor mjaft produktiv i gazetës "Flaka e Vëllazërimit" që botohej në Shkup.

Në viti 1972, punësohet në Radiotelevizionin e Prishtinës, përkatësisht në Radio-Prishtinë si korrespondent nga Peja, prej nga raporton dhe informon opinionin e gjerë për ngjarjet dhe aktivitetet e gjithmbarshme nga ky rajon: Peja, Deçani, Klina dhe Istogu. Në këtë detyrë qëndron gjithnjë deri në korrik të vitit 1990, kur policia serbe me dhunë i dëbon

nga vendet e tyre të punës të gjithë punëtorët shqiptarë të RTP-së (Radiotelevizionit të Prishtinës).

Sejdi Berisha, gjatë punës në Radio-Prishtina ka arritur titullin e Redaktorit të Kategorisë së parë dhe përpos që ka përcjellë zhvillimit dhe ngjarjet

korrespondent i Televizionit të Prishtinës, kurse pas vitit 1980, edhe gazetar i të përditshmes "Rilindja".

Ky krijues, publicist dhe kronist, në nëntor të vitit 1982 nxori numrin e parë të gazetës "Peja" dhe ishte themelues i Radio-Pejës në vitin 1981.

Në vitin 1982 ishte drejtor i këtij institucioni me rëndësi të veçantë informative dhe shoqërore, por duke mos u pajtuar me konceptin e udhëheqjes së atëhershme të Kuvendit Komunal të Pejës, nën patronazhin e të cilit ishte edhe Radio-Peja, e që një konceptin i tillë nuk lejonte hapësirë për punë kreative cilësore dhe profesionale, tërhiqet nga kjo detyrë dhe sërish kalon me punë në Radio-Prishtina.


Sejdi Bajram Berisha është njëri prej punëtorëve më të mirëfilltë të kulturës në Pejë dhe më gjerë. Është anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe i Lidhjes së Gazetarëve të Kosovës.

Ishte dhe mbeti në memorjen tonë tashmë një krijues i denjë i paepur dhe produktiv i opusit të gjerë të letërsisë shqipe – poet, prozator, romancier, dramaturg dhe kronist.

Deri më tani ka botuar 36 vepra letrare në poezi e prozë dhe katër drama të cilat i janë emituar në valët e Radio Prishtinës.

Veprat letrare: 1. "Kombinati i lëkurë këpucëve në Pejë", monografi, (1984), 2. "Tronditje", (poezi, 1991), 3. "Mendia në rreth" (prozë,

1993), 4. "Feniksi" (poezi, 1993). 5. "Simfoni pritjeje" (poezi, 1995). 6. "Zejtarët e Pejës" (monografi, 1995), 7. "Gabim stinësh" (poezi, 1996), 8. "Në cep koha" (poezi, 1997) 9. "Vrasësi i gjumit" (roman, 1999), 10 "Heraldika" (poezi, 2000), 11. "Lumturia e dhembjes" (eseistikë, 2002), 12. "Freskia e pluhurit" (poezi, 2002), 13. "Piramida e ironisë" (eseistikë, 2004), 14. "Plagë në pikturë" (poezi, 2005), 15. "Fjala e gjakut" (tri poema kushtuar Prekazit, Glllogjanit dhe Koshares, 2006), 16. "Shpërputhje koha" (ese, shkrime kritiko-letrare, vështrime jete, 2006), 17. "Kaq shumë vetmi" (poezi të zgjedhura, 2007), 18. "Dashuro një minutë" (poezi dashurie, 2007), 19. "Homazhe tek mendja" (ese, 2008), 20 "E bukura e rrugëtimit" (këndvështrime letrare, 2008), 21. "Fjalë e pathënë" (poezi, 2009), 22. "Zejtarët e Pejës" (monografi, botimi i dytë, 2010), 23. "Kërko dhembjen time" (poezi, 2011), 24. "Mallkimi i heshtjes" (shkrime refleksive, 2011), 25. "Teatri i Pejës" (monografi, 2012), 26. "Vargje të këputura (poezi, 2012), 27. "Përtej shkrimit" (shkrime të plasura, baladë shkrimesh, kujtime, mendime, vlerësime dhe biseda për njeriun, dhe të tjerët për mua, 2013), 28. "Gjethet e hirta të zemërimit" (poezi, 2014), 29. "Në lum bie shi" (poezi, 2015), 30. "Konflikti me vetveten" (Ese, shkrime të tjera, 2016), 31. "Gërshtimi krijues dhe urat letrare" (Analiza dhe këndvështrime letrare, 2016), 32. "Kthimi në shtëpinë që nuk ekziston" (poezi të përkthyer në gjuhën greke, 2016), 33. "Varrtarët kush do t'i varrosë" (poezi, 2017), 34. "Zejtarët e Pejës, roli dhe kontributi i tyre në zhvillimin ekonomik dhe kulturor" (monografi – botimi i tretë, 2017), 35. "Peizazh i jetës sime" (poezi, 2018), 36. "Njeriu pa vendlindje – thjeshtë, dhembja dhe lumturia e jetës bashkë" (libër autobiografik, 2019)..



në territorin e Pejës dhe në tri komunitat tjera të cekura më lart, kohë pas kohe ka raportuar edhe për ngjarjet dhe tubimet më të rëndësishme anë e kënd ish Jugosllavisë. Ka qenë edhe reporter në manifestimet kulturore siç ishte Festivali i Teatrove të Jugosllavisë, Festivali Republikan i Teatrove të Kosovës, Serbisë dhe Vojvodinës dhe Festivali i Teatrove Amatore të Kosovës, të cilat për çdo vit mbaheshin në Trebinje të Bosnjës dhe Hercegovinës, në Kulla të Vojvodinës dhe në Ferizaj të Kosovës.

Për punën cilësore dhe profesionale, Sejdi Bajram Berisha, disa herë është shpërblyer dhe ka marrë mirënjohje. Në ndërkohë, pesë vite ka qenë edhe gazetar-



KUR NJË “RAPSODI... ARBËRESHE” MEMORIZON DE RADËN DHE AGIM MATON NË LONDËR

Grupet e ndrojtura të dritës së diellit në bibliotekën e Croydon-it prekin sipërfaqen e tapetit publik të goditur si putrat e maceve që janë zhvendosur në jetën e përtëjme. Fëmijët kuriozë, të sjellë nga nënat e tyre nervoze për klubin e leximit të pasdites, në të cilin, me dozën e duhur të fatit, është fare e mundur të vendosësh kontakte shoqërore, kalojnë nëpër raftet e mbushur me libra. Korsitë drejtkëndore e të qeta mbysin fluturimin e vetmuar të pensionistëve në atmosferën tematike të rafteve ku seritë e kopshtarisë, gatimit dhe trajnimit të kafshëve shtëpiake ofrojnë tituj shpëtimtarë, zëvendësues për vetminë e ditëve të javës. Të kapsuluar nga interesat, shpirtat vëzhgojnë në heshtje njëri-tjetrin.

I barrikaduar në këndin komod me kompjuterët, kërkoj me zell gjurmët e botimeve unike në botën virtuale të matricës, ku gjithçka, nga prania madhështore e Iliadës e deri te reklamat joshëse të të brendshmeve në skajet dinake të ekranit, bëhet një

vrasës i mëshirshëm i kohës së kaluar me veten time. Asnjë mendim i rëndë për të ardhmen, ose pyetje që të thyejnë zemrën për kuptimin e të jetuarit në rrethana të pakapërcyeshme.

Disa metra më tutje nga prania ime e zhytur, e humbur në spirale të devijimeve të vogla, rri kërrusur një burrë në kulmin e tij, i veshur me uniformën e bibliotekarit vullnetar dhe një vështrim të ngrirë si dritarja e një zyre të braktisur. Rrotullimi centrifugal nga e djathta në të majtë. Ndalon dhe përkulet pak në mënyrë që njëra dorë të prekë dyshemenë. Pastaj përsëri. Pranë tij, karroca e rrëmuqshme me libra për t'i shpërndarë në vendet e zakonshme, duket jetime.

- Ai është autik, zotëri - më kthen një konsulent ndihmës - ai punon me ne vetëm disa orë në javë. Ne po përpiqemi ta socializojmë, ndaj injoroni veçoritë e tij të vogla. Pavarësisht gjithçkaje, ai do të përballojë detyrën e sotme.

Dhe ashtu i përhumur më pas dëgjoj zërin e qetë nga ana tjetër: tani le të fillojmë

të organizojmë seksionin e studentëve. A ju kujtohet se çfarë duhet të bëni përpara se të renditni titujt sipas kodeve?

Toni optimist i nëpunësit nuk mund të më mashtrrojë. Dhjetë vjet më vonë, me një trup të rritur dhe një shpirt ende të mbyllur, ish student i im me nevoja të veçanta qëndron përpara meje. Më kishin paralajmëruar atëherë të mos përpiqesha të ndryshoja paqen e tij të brendshme. Mos prisni shumë prej tij. Mos e prekni. Dhe në asnjë mënyrë për të kaluar dëshirën e tij për të lexuar të njëjtin artikull në internet, kushtuar dragonjve prej letre që zbukurojnë këtë traditë. Një hapësirë e ngushtë, vuajtëse, pothuajse e pakalueshme midis botës së tij dhe times, ku çdo javë përpiqesha të kontaktoja për ta nxjerrë nga skica e pafundme e barrierave të padukshme.

Buzëqeshja miqësore që i jap atij nuk do të thotë asgjë për të. A më kujton ai edhe pas shumë kohësh me këtë ritëm të edukatorëve të tij “normalë”, të zellshëm, profesionistë, të paguar dhe të stërvitur për ta ndikuar sistematikisht nga

lumturia e pakuptueshme e heshtjes së brendshme?

Një zë i prekshëm përshkon atmosferën e përgjumur të bibliotekës. Një student, përplaset në perimetrin rrethor të vendosësit të librave dhe me këmbëngulje fillon të rrokulliset në dysheme, si për të arritur fjalën “dua”, e cila kërcën si një lodër e rrahur me bateritë e çmendura nga mbinxehja.

- Ben, ndalo - këmbëngul përkujdesësja e tij, e zënë ngushtë nga kurioziteti i heshtur i të pranishmëve - nuk kam si ta di se çfarë janë këta “Rapsdi...”, që po kërkon! Le të shkojmë, do të shkojmë në shtëpi.

E shqetësimi i tij kthehet në fishkëllima të rreckosura, sikur hapësira e dëshpëruar në rrrathët e padukshëm të ketë gëlltitur shansin e tij të fundit për siguri. E shikoj situatën me zhurmë, sepse e di se çfarë do të ndodhë më pas. I hedhur jashtë ritmit të rutinës së tij të zakonshme, ish-studenti im fillon të lëkundet si një marionetë, mbrapa dhe mbrapa, majtas dhe djathtas ..



+



PROFESIONALIZËM • GARANCI • CILËSI



**ABONIME
INSTALIME
RIMBUSHJE**

PËR MË SHUMË KONTAKTO GËZIMIN: 078 157 359 45



SALMAN ŞIRINGÜL

Arya

SUPERMARKET






SUPERMARKETI “ARYA” ZGJEROHET DHE UDHËHEQ NDAJ KONKURRENTËVE NË GRAVESEND

Investimet e larta dhe çmimet e ulëta duket se po prishin rendin e vendosur në sektorin e supermarketeve në Mbretërinë e Bashkuar. Shitësit me pakicë po bëjnë një sfidë ndaj konkurrentëve të tyre në Mbretërinë e Bashkuar me investime të rritura dhe çmime më të ulëta, duke prishur rendin e vendosur. Supermarketi “Arya” po ndjek lidhet e tregut me rivalët e tij në Mbretërinë e Bashkuar me njoftimin e një investimi të ri duke hapur hapësirën ekzistuese me stenda të reja dhe çmime më të ulëta.

Plani është krijuar për të përshpejtuar zgjerimin e tij në të gjithë hapësirën dhe për të mbyllur hendekun me lojtarët e mëdhenj të zonës në fjalë. Më shumë se një hapësirë komode dhe mjaft të shfrytëzuar është planifikuar nga pronari i saj z Salman deri në fund të vitit. Pamjet aktuale flasin për një biznes të hapur, konkurrent dhe mjaft efikas për komunitetet e tjera, sidomos për komunitetin shqiptar në atë zonë.

Për të ndihmuar në menaxhimin e kërkesave të zinxhirit të furnizimit për të furnizuar më shumë klientët në mënyrë më efikase, “Arya” planifikon të zgjerojë asortimentet dhe produktet e saj nga zona rajonale të shpërndarjes dhe të përditësojë infrastrukturën

Supermarketi „Arya“ zgjerohet dhe udhëheq ndaj konkurrentëve në Gravesend



www.fjalaelire.com
Nëntor 2024, Londër

teknologjike që mbështet funksionimin e tij. Në tre muajt e fundit, shitjet me pakicë kanë qenë mjaft të kënaqshme. Tani supermarketi kryesor në këtë zonë, sipas Retail Economics, “Arya” po i afrohet rivalëve kryesorë me pakicë me performancë në sektorin e super konkurrencës.

Rezultatet tregojnë periudhën më të lartë të rritjes së shitjeve ndonjëherë.

Pronari i “Arya” z. Salman , thotë se ai është i përqendruar në rritjen e ritmit duke ofruar vlerë për konsumatorët me para në dorë: “Blerësit komunitarë dhe vendas po

votojnë me këmbët e tyre dhe po zgjedhin “Arya” si supermarketin e tyre të parë. “Ne po përgjigjemi me investimin tonë më të madh vjetor në Gravesend.” Ai vazhdoise ne po investojmë duke ndërtuar infrastrukturën e furnizimit për të sjellë sende ushqimore me cilësi të lartë dhe të përbalueshme për mjaft familje të tjera në gjatësinë dhe gjerësinë e zonës.

“Arya” ka marrë gjithashtu vlerësime nga sektori i shitjes me pakicë në Gravesend. Vendasit, klientët dhe komunitetet flasin fjalët më të mira. Të gjithë ishin të impresionuar nga rritja e tij gjatë muajve të fundit dhe oferta e saj me vlerë. Përfshirja e saj e komunitetit, si ofrimi i dhurimeve ushqimore, u vlerësua gjithashtu.

Një klient përmbodhi ndikimin e “Arya”, duke thënë: “Arya ka një biznes të jashtëzakonshëm ku ka zënë një pjesë të madhe të tregut të zonës së Gravesend. Nëse pjesa tjetër e supermarketeve nuk bëjnë diçka, kjo do të vazhdojë.”

“Kur dyert e dyqanit tonë të parë u hapën, thotë z Salman, premtimi ynë ishte i thjeshtë: Ofrojini klientëve ushqime me cilësi të lartë me vlerë të pakrahasueshme dhe ky angazhim ende qëndron.” Ai shtoi: “vlera dhe respekti nuk është thjesht një slogan i markës. Është një premtim që mishëron atë që përfaqëson biznesi ynë dhe përmbledh angazhimit tonë ndaj përgjegjësisë sociale dhe qëndrueshmërisë, që është thelbi i ADN-së sonë. Me kalimin e muajve kjo ka ndihmuar në një ndryshim të rëndësishëm në mënyrën se si familjet e zonës së Gravesend blejnë sendet e tyre ushqimore.”



LILJANA TROQE: VOLEJBOLLISTJA VLONJATE QË FUTI EKIPIN ELBASANAS NË KATEGORI TË PARË

Nëse ajo që na ka shkuar, nuk na ndjek përpara, por edhe nuk na sfidon përpara me kohën, ne do të kemi vetëm veten për të fajësuar! Kështu m'u kujtua ose ky mendim më erdhi kur, krejtësisht lexova disa poezi të vlonjates, Liljana Troqe, dhe më së shumti kur u ngacmova nga një koment në një nga poezitë e mia. Isha me nxitim sepse një ditë e imja është me shumë vrap, me shumë nxitim...Dhe kjo jo thjesht rreth punës, apo punërave të mia. Një takim unik me një pjesë të së kaluarës së Shqipërisë mesjetare, më bënte të largohesha disi nga Arkivat Britanike dhe të shkoja midis një kohe tjetër, ose më saktë me atë mesazh që lexoja nga Liljana Troqe: "Një kohë e shkuar!". E aty u ndala dhe nisa të mendoja, ose të rilexoja ëndrra...Diku më dukeshin të realizuara, e diku të porealizuara...Ëndrrat e porealizuara janë një fenomen i pakapshëm, prandaj nuk mund të zbuten me fjalë dhe kufizohen me pafundësinë. Të arriturat, megjithatë, shpesh e ngushtojnë hapësirën e tyre në hapësirë, kohë dhe vend por e zgjerojnë në informacione të shkurtra dhe të sakta për kohën e caktuar në detaj, të cilat në rastin e fundit reflektojnë si një rrjedhë e një fakti jeti që vijon. Me këtë rast mendimi shkon në kanal, e duhur për këtë intelektuale dhe poete të heshtur, të thjeshtë e të talentuar, por dhe një sportiste disi e lënë në harresë në Elbasan, një nënë shembullore, një vajzë e përjetshme sportive dhe rinore, një talente që ka ende bulat e djersës tek volejboli elbasanas.... Por Liljana Troqe është dhe autorja e tekstit të këngës mjaft të bukur "Vjen një çast", pra me tekst nga

Liljana Troqe dhe muzika nga Ilir Dangëllia, që është kënduar nga e mirënjohura pogradecare, Ermira Baliu dhe që fitoi në një festival universitar... (F. Terziu)

Liljana Troqe: "Një kohë e shkuar!"

Aty nga viti 1967-68 na mbyllën pedagogjiken e Vlorës dhe na çuan në Elbasan te shkolla e mesme Pedagogjike, "Luigj Gurakuqi". Ishte një emër i lexuar, po as në ëndërr nuk e kishim parë veç njohjes nga ana historike. Nejsë bëmë gati valixhet e drurit, futëm ato plaçka që kishim dhe u nisëm një grup vajzash nga Vlora. Ndaluam në Rrogoxhinë të prisnim trenin dhe zgjatëm syrin nga dyqanet, dhe si rini harruam, dhe ngelëm me një shoqen time në Rrogoxhinë.

Thamë se u përmbys bota. Kjo kuptohet nga mosdalja, dhe jo aq nga padija, por dhe se ishim vajza, vajza të asaj kohe, të atyre viteve. Me mundim të madh gjetëm një makinë. Ajo ishytte një makinë e tipit ngarkim-shkarkimi, që shkante në Elbasan. Na iku ajo ëndrra ta shijonim Elbasanin siç e kishim menduar mbrëmjeve. Shoferi na çoi te porta e shkollës, pikërisht aty ku na prisnin pothuajse të gjithë me gjak të ngrirë. Atmosfera e gëzimit i kapërceu dyert e hekurta të asaj shkolle të bukur, menjëherë sapo e pamë. Atë bukuri të jashtme e shijam edhe nëpër klasa kur na hynin mësues, që filuam t'i adhuroam sapo filluam orët e para të mësimit.

Ftesa për volejbollin e Elbasanit

Por do të kalonte shtatori dhe mua do më vinte një

ftesë për të ringritur ekipin e volejbollit të Elbasanit, meqë kisha qenë volejbolliste e Flamurtarit. Ju futa me pasion duke marrë edhe dy shoqe të mia dhe arritëm të fitojmë dhe ta futim Elbasanin në kategori të parë.

"Dhjetçi" që ngriti peshtë sportdashësit elbasanas

Kur hyja në Këndin e Lojërave me Dorë, (se atëherë nuk kishte Pallat Sporti), ngriheshin në këmbë dhe thërrisnin si në korr: "Dhjetçi, Dhjetçi, Dhjetçi...", se mbaja numrin 10-të në fanellën e Elbasanit.

Pse u nisën këto kujtime?

Ah, doja t'ua tregoja se pse po ti nis këto kujtime. Sepse për nderin që u bëra duke i futur në kategori të parë vetë Kryetari i Komitetit i bëri letër Vlorës, që unë të caktohesha mësuese fiskulture në qytet.

Vlerësimi më tutje

Nga 9 matura që ishim në atë vit vetëm unë u caktova mësuese në qytet. Nderim më të madh nuk kishte. E fundja kush isha unë? Vija nga një familje e thjeshtë e të caktohesha unë në qytet. Ja pse e ruaj respektin për atë Elbasan, për drejtorin e shkollës tejet rigoroz Vasil Kamani, për mësues Genci Stringën, e biologjisë që më krijoi kushte speciale të mësoja në laborator meqë isha sportiste e atj qyteti...e shumë të tjerë.

Tani tek arsyeja e këtij shkrim-prezantimi

Unë nuk i harroj dhe kur hapa emrin tuaj dhe pushë që ishit nga Elbasani nuk di pse më



ngacmuat atë mirëdashësinë e atij qyteti që ndoshta nga kjo që nisa thjesht do mundohem nën atë stilin tuaj ta zgjeroj tregimin kur të plakem edhe ca!

Dhe së fundi!

Skoti i kërkoi Heminguejit t'i thoshte dy fjalë për një tregim që ja kish dhënë.

Dëgjo, - i tha Hemingueji - do t'i them të mirat, por dhe ca gjëra që nuk më pëlqyen.

Dakort, - i tha Skoti.

Tregimin e filloje bukur rreth psh një personazhi, por rrugës e transformove, ç'pate që e bëre tjetër?

Dhe unë ju kam vënë re se këpucës i shkoni deri në fund, gjilpërës i hyni deri në kashtë, po se po. Gruas i thoni fjalë të bukura, duke e shtrirë deri te emri përgjithshëm, Grua. Apo, edhe te emigranti...Sepse, lexoj ca poezi që shkasin si tregimi Skotit ... diku, dhe unë prandaj qëndroj tek poezia juaj, që është figurativisht shumë lart dhe filozofikisht shumë thellë, por atë që kap pena juaj e bën të vdekur...



ARRESTIMI I OPOZITËS ËSHTË BUTONI BËRTHAMOR NË POLITIKË



Nga Gazmend Cufaj
Kryetar i Grupseksionit
të PD-së Barking dhe
Dagenham

Në muajin e fundit, ne kemi parë një rënie të dukshme të mbështetjes publike për kabinetin qeveritar Rama. Kabineti mbete akoma më i pafat. Ka hyrë në një sërë krizash, të cilat duket se po kalojnë në kriza socio-ekonomike dhe gjeopolitike. Problemi i problemeve janë çmimet, jo situatat, dhe ne kemi një problem që është shumë herë më i madh se të tjerët së bashku, ky problem është qëndrimi i gjatë dhe mjaft korruptiv i qeverisë që drejtohet prej Kryeministrit, Edi Rama, pasi shumë anëtarë kabineti, dhe drejtues të lartë janë në burg dhe në ndjekje penale.

Qeveria filloi me një mbështetje të mirë fillestare, kur krahasojmë për shembull të dhënat me të dhënat e mëparshme nga disa vite më parë, dhe vazhdoi deri në një periudhë me një besim relativisht të lartë. Ajo që kemi parë muajt e fundit është një rënie e dukshme e mbështetjes publike për kabinetin. Sigurisht që faktorët nuk janë një apo dy, janë një sërë faktorësh. Para mbajtjes në arrest shtëpie të Liderit të Opozitës, Sali Berisha, deri pas arrestimit të ish-Presidentit Ilir Meta, që është dhe President i Partisë së Lirisë, parti që përbën opozitën me PD-në, situata qëndroi statike, me një rezultat të afërt me atë të marrë në zgjedhjet e kaluara. Ky është butoni bërthamor në politikë, të arrestosh liderin e opozitës. Duhet të kesh prova

të pakundërshtueshme në drejtim të këtij arrestimi për ta bërë me urgjencë. Ajo që më shqetëson është se kjo urgjencë, me sa kuptoj unë, bazohet në dëshminë e një Ministri socialist, e cila e rëndon edhe më shumë situatën. Politikisht, ky është një rehabilitim i pjesshëm, që shihet si një efekt bumerang dhe një luftë interpretimesh. Kur bëhet fjalë për arrestimin e kreut të opozitës, në radhë të parë është një akt politik, nuk është thjesht ndalim i një individi. Në këtë rast, je i detyruar të kesh prova të tilla, përmes të cilave mund të bindësh audiencën se ke të drejtë, se ka nevojë për këtë gjë. Përndryshe, na mbetet një shije e hidhur. Pikërisht këtë nuk e kemi parë ende dhe nuk e pamë dhe kur u arrestua deputeti opozitar Sali Jani. Nëse bëhet fjalë për rrëshqitje të dikujt, nuk e di se cili është roli i atyre që lëshojnë urdhëra të tilla arrestimi. Nëse nuk ka përgjegjësi për t'u marrë, do të rëndojë si gur mulliri mbi këtë administratë. Sikurse dihet partnerët politikë i kanë marrë vesh nga mediat arrestimet dhe presidenti ka reaguar "mjaft gjakftohtë", me një qëndrim të arsyeshëm, që është "një hap tjetër në distancë nga presidenti". Unë nuk shoh se çfarë fituan nga kjo. Nuk shoh asnjë

pikë në të cilën palët fituan, përveç se edhe një herë thanë ndarazi, të parët në pushtet thanë se ne jemi të mirët, dhe ata në opozitë shtuan zërrin duke thënë se SPAK, pra Prokuroria e Posaçme është e keqe. Ka dëmtim të imazhit publik e të gjithë të anketuarve thonë se kanë ndryshuar qëndrim në drejtim negativ, por ka një gërshetim të shumë shtresave. Ka dëmtim imazhi, vetëm se tek shqiptarët dominojnë qëndrimet pacifiste. Një anketë e anashkaluar me 8 Dhjetorin e këtij viti raporton një rritje të mbështetjes për Opozitën, ndoshta jo kolosale, por lufta gjithmonë forcon polet. Kur merr një qëndrim radikal, të ndryshëm nga ai që kanë mbajtur pothuajse të gjithë të tjerët, është normale që rusofilët e guximshëm të shohin Edi Ramën duke ikur, dhe Sali berishën si përfaqësuesin e tyre legjitim politik në këtë situatë. Një pjesë e madhe e kapitalit të diskutueshëm është për shkak të kësaj. Me këtë situatë edhe pse kjo nuk do të jetë domosdoshmërisht e përhershme dhe Opozita është pozicionuar në Mosbindje Civile në këtë situatë, ka fituar kapital politik, por sfida përmes projektit të tillë do të jetë që të mund të qëndrojnë në krye të valës për tema të tjera më të debatueshme në ditët në vazhdim, deri në zgjedhjet e përgjithshme të 11 majit 2025.



CERTIFIKATË VLERASH PËR Z GAZMEND CUFAJ SI DREJTUES I KOMPANISË “BIG BOSS SERVICES UK LTD”

Kompania “Big Boss Services UK Ltd” që drejtohet nga z Gazmend Cufaj, ka kohë që është bërë një nga emrat më të vlerësuar nga klientët dhe shërbimet që ajo kryen në MB. Për këtë është vlerësuar sonte nga revista “Albanian Post” UK, që drejtohet nga Fatmir Terziu në Mbretëri të Bashkuar, me një certifikatë për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në promovimin e vlerave shqiptare me angazhimin e tij drejtues në kompaninë që ai drejton dhe për vlerësimet që ka marrë nga klientët e kompanisë së tij gjatë vitit 2024 z Gazmend Cufaj. Certifikata e arritjes iu dha z. Gazmend Cufaj në një natë festive ku kompania në fjalë ishte mbledhur për të festuar festat e fundvitit, si dhe për të analizuar punën një vjeçare. Në një natë të tillë festive kompania “Big Boss



Services UK Ltd” festoi dhe u angazhua për më shumë përkushtim, arritje dhe vlera në funksion të rritjes më të madhe të profesionalizmit. Kjo kompani është propozuar më këtë rast edhe si një kompani për tu nominuar për Çmimet Kombëtare të Ndërtimit. Duhet të sqarojmë se Çmimet Kombëtare të Ndërtimit përbëhen nga

21 kategori që lejojnë çdo biznes të suksesshëm në MB të hyjë në këto çmime prestigjioze. Të gjitha hyrjet vlerësohen nga deri në 4 nga paneli kombëtar i gjyqtarëve. Me këtë rast kompania dhe stafi i saj që operon në Londër festuan arritjet, zhvillimet dhe inovacionin në të gjithë punën e tyre në lulëzim dhe që përmban

një gamë të gjerë kategorish për ofruesit e zgjidhjeve, furnizuesit, kontraktorët, arkitektët, inxhinierët civilë, zhvilluesit, autoritetet lokale dhe më shumë.

Një përgëzim i madh për këtë natë festive dhe për propozimin për çmim vlerësues në London Construction Awards. Me një numër rekord të hyrjeve këtë vit, konkursi shfaq inovacionin, rritjen dhe diversitetin e jashtëzakonshëm

që nxit industrinë e ndërtimit në MB. Edhe nata festive e organizuar me këtë rast nga Kompania “Big Boss Services UK Ltd” ishte një natë për t’u mbajtur mend! I urojmë stafit drejtues dhe Kompanisë “Big Boss Services UK Ltd”, si dhe vetë z Gazmend Cufaj suksese dhe Gëzuar festat e fundvitit.

BIG BOSS SERVICES UK LTD

BUILDING CONTRACTORS

Our services include:

Guttering
Painting
Decorating
Power Clean
Scaffolding
PVC Windows
Loft Conversion

Plastering
Carpentry
Roofing
Brickwork
Tiling
Kitchen Fiting
Extentions
Bathroom Fitting

Gazmend Cufaj

Thank you
so much!

KONSULTIMI me ekspertët është
ZGJIDHJA MË E MIRË për ta
shmangur humbjen.

big_boss_services_uk_ltd

BigBossServicesUKLtd

@BigBossServices

Tel: 020 8591 9198
Mobile: 07747 143 704 / 07883 029 474
Email: bigboss-services@yahoo.co.uk
website: www.bigboss-services.webs.com
UTR: 7168616298
CRN: 8344897
VAT NR: 215642524

Shesim apartamente në Durrës,
Tiranë dhe në
zonën e Plazhit
deri tek Mali i Robit

Kontakto:

07883029474 dhe 00355685309800



MJALTI, “ASSA PURE ORGANIK” MUND TË SIGUROHET TEK “IMPERIAL”

Në Qarkun Hertfordshire të Britanisë së Madhe është shtuar prej disa kohësh një markë e re mjalti. Ky mjalt është prodhim i bletëve të shqiptarit Artur dhe ajo është e ndarë në dy grupe. I pari i përket mjaltit puro të prodhuar nga këto bletë dhe i dy ti i përket mjaltit “ASSA” të prodhuar po nga bletët e tij. Mjalti i i këtyre bletëve që zotëron Arturi, është i pastër, natyral dhe është një dëshmi e traditave dhe vlerave të bletarisë që ka marë, zotëruar dhe udhëhequr ai në disa kohë në biznesin e tij familjar. Arturi ka pasur një lidhje me mjaltin që në kohën e tij fëmijore pasi ka qenë gjithnjë afër dhe ka mbajtur koshere bletësh që kur ishte fëmijë. Ai sapo erdhi dhe u vendos në zonën ku jetoj dhe punon menjëherë pa produktet e këtij lloji nën etiketën “English Honey” dhe menjëherë u frymëzua dhe u shty më shumë që të krijonte kosheret e veta, me synimin për t’i ofruar komunitetit lokal e më gjerë mjaltë të pastër dhe cilësor.

Duke filluar me pak koshere, ai shumë shpejt e pa të arsyeshme me rritjen e kërkesës, duhej të zgjeroheshin kosheret dhe e bëri mjaft shpejt! Që atëherë, ai ka ndërtuar një grup të fortë prej disa kosheresh, nëpër zonën e gjerë të Hertfordshires, të cilat më pas i përkujdes dhe i shfrytëzon për qëlimin e caktuar. Ai me këtë rast ka mësuar

thelbin e kësaj pune, pasi e di se kolonitë e bletëve të mjaltit tani gjenden shumë rrallë në natyrë, kështu që popullatat e shëndetshme të bletëve varen nga bletarët vendas. I gjithë mjalti i tij prodhohet nga koleksioni i koshereve, vendase në Hertfordshire. Këto bletore prodhojnë tufa të vogla mjalti, secila e veçantë dhe e dallueshme nga të tjerat.

Duke punuar sipas metodave tradicionale të bletarisë,

disponueshëm për bletët kur prodhojnë mjaltë në këtë periudhë të vitit.

Për shkak të niveleve më të larta të glukozës në këto polene, mjalti i pranverës ka më shumë gjasa të mpikset në një periudhë më të shkurtër kohore. Ngjyra e mjaltit shihet me këtë rast të ndryshojë në bazë të nektarit që mbledhin bletët e tij. Për këtë arsye, mjalti natyral do të ndryshojë çdo vit. Mjalti, “ASSA pure organik” është

tonë të zhytësve të mjaltit për të arritur deri në fund të kavanozit! Misioni është të marrë pjesë në ngjarje lokale dhe të mbështesë komunitetin e gjerë në rritjen e ndërgjegjësimit rreth rëndësisë së bletarisë dhe trashëgimisë së saj, në mënyrë që ajo të vazhdojë të lulëzojë për shumë breza që do të vijnë.

Përfitimet shëndetësore të mjaltit të pranverës së Hertfordshire janë të mëdha.

Mjalti i pastër është një ëmbëltues natyral, karbohidrat natyral, agjent anti-inflamator, antioksidant dhe antibakterial. Ndryshe nga shumë marka që gjenden në supermarkete, mjalti i Arturit ofron më shumë përfitime shëndetësore për shkak se nuk shtohet ose hiqet.

Ajo markë, pra mjalti i Arturit mbetet një markë e përkryer për përdorim të përditshëm. Seti i mjaltit të pranverës Hertfordshire mund të jetë një shtesë për tostin, qullën ose kosin tuaj si një majë e ëmbël. Është ideale edhe për pjekje. Mjalti është një zëvendësues ideal për sheqernat e rafinuara. Ky produkt është i përshtatshëm për vegjetarianët, por jo i përshtatshëm për foshnjat nën 12 muajsh.

Arturi sqaron: “Ruajeni në temperaturën e dhomës. Ju lutemi vini re se kristalizimi mund të ndodhë natyrshëm për shkak se është një produkt natyral. Nëse kjo ndodh, vendoseni kavanozin në ujë të ngrohtë dhe ngrohjeni butësisht në një strukturë që preferoni.” Mjaltin e Artur mund ta siguron duke e blerë edhe tek “Imperial” në Kilburn High Road në Londër.

Mjaltin tonë të pastër

BENEFITET

- ✓ QETËSON DHIMBJET E FYTIT
- ✓ PËRFORCUES NATYRAL I IMUNITETIT
- ✓ NJË SHPËTIMTAR I ËMBËL I LËKURËS
- ✓ PËRMIRËSON DISPONIMIN TUAJ
- ✓ I PASUR ME ANTIOKSIDANTË

100% i pastër dhe natyral, pa asgjë të shtuar, apo hequr. Çdo kavanoz me mjaltë nxirret, dhe etiketohet nga vetë ai. Duke vepruar kështu, ai siguron që produktet me cilësi më të mirë të arrijnë tek klientët dhe familjet e zonës. Seti i tij i mjaltit të pranverës Hertfordshire ka një shije të ëmbël, me lule për shkak të lulëzimit të hershëm dhe ushqimit natyral të

ai tashmë mban bletë të shëndetshme dhe punon në partneritet me pronarët lokalë të tokave për të siguruar që produktet me cilësi më të mirë të arrijnë tek klientët dhe familjet e zonës. Seti i tij i mjaltit të pranverës Hertfordshire ka një shije të ëmbël, me lule për shkak të lulëzimit të hershëm dhe ushqimit natyral të

100% i pastër dhe natyral, pa asgjë të shtuar, apo hequr. Çdo kavanoz me mjaltë nxirret, dhe etiketohet nga vetë ai. Duke vepruar kështu, ai siguron që produktet me cilësi më të mirë të mbesin konkurrentë. Kavanozët standardë kanë një peshë neto të fiksuar dhe bashkëpunojnë në mënyrë të përsosur me gamën



VLERAT E KOHËS NË LIBRAT E SHERIF BLLACËS

Kur u njoha për herë të parë me Sherif Bllacën, pashë se kishim çdo gjë të përbashkët me të. Ai shëmbëllente një ndjenjë familjare dhe qytetare, intelektuale, me të cilën u bë boshti i bisedave rreth të cilave rrotullohej gjithçka, Atdheu, ngjarjet, njerëz dhe angazhime.

Kështu, biseda gjente lehtësisht një gjuhë të përbashkët me tjetrin, qoftë për shkak se kishte një kuriozitet të thellë dhe të sinqertë për botën, që shkon paralelisht me poezinë. Ishte poezia ajo që na bashkoi në vitin 2005. Vite më vonë, përpiqeshim të kthehemi dhe të flasim për jetën para, gjatë dhe pas ndërsa lexoj përmbledhjen e tij të parë me poezi që në thelb ka shtëpinë, prindërit, familjen, Atdheun, dashurinë dhe respektin njerëzor.

Qëndrimi në Britani të Madhe i mësoi më shumë për lirinë dhe pavarësinë, ashtu sikurse ëndërronte kur duart i bëheshin gjak nga qepja e këpucëve në kohën kur e kishin internuar në Shkup të Maqedonisë së Veriut, në ish-Jugosllavi. Dhe nëse vende dhe kultura të ndryshme luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e Bllacës, qyteti i Pejës është i një rëndësie kyçe për poezinë e tij. Në kohën kur u shkrua teksti [në libër], ndjente një lidhje të fortë me botën rreth tij, me qytetin, me dashurinë e familjes apo dashurinë që nuk ndodhi. Dhimbja e përvojave të rinisë ishte e fortë. dhe u shfaq lehtësisht, por edhe kaloi lehtësisht. Bota ishte një vend shumëgjyresh që i solli emocione të stuhishme dhe bëri jehonë.

Duke u ndalur te tekstet në

librat e tij, fillojmë me listën e gjatë të tematikave të preferuara, më pas marrim ritmin për të kaluar gjuhën që duam të zotërojmë, por askush prej nesh nuk e di, për të pikturuar një portret imagjinar të muzës, dhe të ndalemi kur të vijë koha për... tema të tjera.

Sherif Bllaca e ka shtuar aritmetikën e botimeve të tij. E ka vendosur në rreth pesë libra. Me peshën intelektuale të viteve ai tashmë ka librat nën siglën e tij. Por ai mbetet modest. Mbeti Njeri. Dua të them që në fillim se modestia dhe sinqeriteti i njeriut shihet qartë në thënien e hapur të Sherif Bllacës. “Unë nuk jam as poet, as shkrimtar, por një dashamirës që dua me vargje të shprehë dhimbjen, dashurinë dhe mallin nga këto pozicione ku jam”, - shprehet ai. Kështu është shumë lehtë të udhëtosh në këtë modesti mes vargjeve të tij, që sjedhin po atë sinqeritet dhe domethënie në gjuhën shqipe të ruajtur pastër në sepetat e shtrenjta të traditës dhe kulturës së familjes së tij Pejane. Duke lexuar e njohur mirë këtë traditë dhe përkushtim të hershëm të Bllacajve, natyrshëm lehtësohesh dyfish. Njëherazi prej karakterit të Sherif Bllacës dhe për së dyti nga krenaria që shijon në këtë oxhak të pasur qytetar, kulturor dhe patriotik shqiptar. Kjo gjendet edhe në strofat e tentuara poetike të Sherifit, shihet edhe në mesazhin e vëmendshëm e domethënës shpirtëror të njeriut që gjendet i gatshëm në mes ndjenjës, lotit, pikës së djersës dhe rrudhjes mendore për të përcjedhur dashamirësinë e ndjenjën njerëzore tek tjetri, tek brezat. Kjo lloj krijimtarie synon

një marëveshje të heshtur dhe shtjellon deri në detaj forcën e karakterit të njeriut në imigrim që pushtohet nga mijëra probleme të jetës që e rrethon. E këtu është pikërisht ky varg që vjen në ndihmë ashtu duke sfidur tërësinë rrethuese.

Në mjaft poezi të Sherif Bllacës, zë vend e tashmja dhe shqetësimi i saj, e shkuara lakohet dhe lathet në stilin popullor dhe e ardhmja është një sfidë në mesazhin e tij të dobishëm. Poezitë e tij “Ajo është bujare”, “Në pranverë”, “Dielli dashuron”, etj kanë një lidhje tepër të ndjeshme me këtë harmoni kohore dhe me stilin e traditën popullore të vargut. Sherif Bllaca ka një arsye të qartë që e gjen forcën e mesazhit tek vetja, tek personalja dhe jetikja. Ai është një ndërlidhje historike që kapërcen emocione dhe dhimbje, një dëshmitar i shumë rrjedhave politike dhe Kombëtare dhe për të flamuri, Skënderbeu, Kombi, Peja dhe tërë Kombi janë simbole zemrash, jo thjesht zgjedhje simbolike për të shprehur dashurinë, dhimbjen dhe ndërtuar mesazhin e tij.

Në leximin kronologjik të vargut të Bllacës shihet një grumbullim vitesh, një magazinim idesh dhe njohurish që shpërthejnë në kohë, vend dhe hapësirë të gjetur. Ai di të fiksojë të mirën, të dënojë regresiven dhe të urdhërojë një ndjenjë për progresiven. Në këtë hapësirë vargu i tij kapërcen disa barriera, që shpesh duken në trajtëformim, gjuhë, strukturë e ligjësinë poetike. Edhe pse



ndodh dhe shihet qartë se deridiku është një modesti krijuese jashtë ligjësisive, vlerat e krijimtarisë së Bllacës, janë në nivel, pasi ai krijon për të vlerësuar ndjenjën dhe jo për të krijuar të veçantën. Bllaca sjell në mesin e lexuesit atë që ndjen dhe atë që mendon, ndaj edhe pse diku shfaqen mangësi ai ka vlera mesazhi, vlera që duhen parë e vlerësuar mirë.

Unë nuk do të nxitohesha të lartësoja krijimtarinë e Bllacës, por as t'a nënvlerësoja atë. E thënë troç, në këtë sfidë autori ka fytyrën e vet, ka fjalën e thjeshtë, ka një hapësirë që mund të lexohet nën pushtetin e vargut të lirë, nën ndjenjën e fjalës shqipe të shprehur nga zemra dhe autorësia e lotit dhe dhimbjes në imigrim. Krahas kësaj poezitë “Nënës”, “Ibrahim Rugovës”, apo mjaft figurave të tjera historike dhe patriotike dhe po aq ato familiare kanë një stil tipik që flet shumë, dhe me pak punë kapin nivele të lexueshme. Kështu poezia e Sherif Bllacës të bën të ndjehesh mirë, të bën të ndjesh frutin e një njeriu që përkushtohet dhe shkruan pa bujë. Ai natyrshëm e ka një arsye. Dhe ajo mbetet tek Njeriu! Mbi të gjitha aty janë edhe vlerat e kohës në librat e Sherif Bllacës.



Hilal Food Centre me pamje estetike të re: Ullirin dhe produktet shqiptare i blejmë si në Atdhe





HILAL FOOD CENTRE: GËZUAR FESTAT E FUNDVITIT


Ushqimet tipike shqiptare si ullinjë, sallamrat, salsiçet, lakër turshi, fasulet, produktet e ndryshme dhe veçanërisht erëzat janë ndër produktet më të kërkuara nga shqiptarët që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit. Kështu ndajnë me “Albanian Post” pronarët e Hilal Food Centre në Kilburn High Road. Ne blejmë djathë kaçkavall, djathë, sallam, komposto nga ky furnizues, thotë Agim Beshiri, i cili është një punjonjës në një zjarrfikëse në Londër. Shumë shqiptarë blejnë tërësisht mallra vendase, pasi nuk u pëlqen shija e asaj që ofrohet në dyqanet angleze. Ata blejnë fileto, fara luledielli, peta byreku, bakllava, produkte të ndryshme turke dhe greke, mesdhetare, vafle e shumë të tjera. Çmimet e një pako me peta byreku janë shumë të ngjashme me ato në Atdhe, sikurse një kavanoz lutenicë, një kilogram djathë është dhe një copë sallam po ashtu. Trajtimet e ëmbla janë gjithashtu të kërkuara

në MB. Një kuti e ëmbëlsirave turke, një kuti me vafle natyrisht është shije e mjaft familjarëve. Ka edhe turshi, turshi me lakra e domate, të përziera dhe janë të pëlqyera sidomos nga të rrinjtë që nuk kanë shumë traditë për ti parapërgatitur ato. Farat e lulediellit janë gjithashtu të disponueshme, sikurse dhe mjaft biskota, gurabije e produkte të tjera që zakonisht i shkojnë traditës shqiptare dhe kërkesave familjare. Kudo në Londër e më gjerë, ku ka komunitete të mëdha shqiptare, po zhvillohen edhe biznese paralele, pjesa kryesore e të cilave janë dyqanet. Për shembull, në Britaninë e Madhe ka shumë



vende ku mund të merrni ushqime dhe pije shqiptare, por me çmimet konkurruese mbetet Hilal Food Centre, e udhëhequr nga sivëllai i shqiptarëve z Mahmut. Përveç dyqaneve shqiptare, shumë nga mallrat mund të blihen edhe në ato turke, por gjithnjë konkurenti dhe sfiduesi mbetet Hilal Food Centre. Gjithçka që mund

të blihet në Shqipëri nga dyqanet është në shitje tek Hilal Food Centre. Çmimet në kryeqytetin e Anglisë, sidomos tek Hilal Food Centre janë të ngjashme me ato në vendin tonë, por ndryshimi është se të ardhurat e banorëve tanë atje janë dukshëm më të larta, të paktën dyfish. Tarifa më e ulët për orë në MB, pavarësisht nga kombësia, është 12 £. Një kanaçe me supë me gjethe kushton 1,99 £. Për krahasim, në vendin tonë e njëjta ulje kushton njësoj dhe paga minimale është nën disa lekë në orë. Kështu, në vendin tonë me një orë punë mund të bleh më pak se dy kanaçe dhe në Londër, p.sh., 5 kanaçe me lëngun e preferuar energjetik. Tashmë Hilal Food Centre ka marë dhe një pamje të re, dhe hapësira e ndryshuar më estetike e bën këtë supermarket akoma më të dashur për shqiptarët, dhe akoma më të konkurrueshëm si në estetikë, çmime, pastërti e siguri në blerje e shërbim.





HILAL FOOD CENTRE

Supermarketi me produktet,
çmimet, vlerat, cilësinë e
ushqimeve, produkteve, mishit,
vezëve. Konkurrin kudo!



Supermarket
PAUZA E RE 2024



Kontakto
02073721059



Email
INFO@HILALFOOD.CO.UK

MIRË SE VINI

